

Elbasan, më ____ .02.2023

PROCESVERBAL- Tipi i kontratës - Shërbime

**PËR ARGUMENTIMIN DHE MIRATIMIN E SPECIFIKIMEVE TEKNIKE DHE
KRITEREVE PËR KUALIFIKIM**

(Ky procesverbal është për efekt publikimi bashkë me dokumentet e tenderit)

OBJEKTI I PROCEDURËS: “Blerje karburanti”

KODI PËRKATËS NË FJALORIN E PËRBASHKËT TË PROKURIMIT (CPV): 09100000-0

VLERA E FONDIT LIMIT: 19,066,667 (nëntëmbëdhjetë milion e gjashtëdhjetë e gjashtë mijë e gjashtëqind e gjashtëdhjetë e shtatë) lekë pa TVSH.

Loti 1 : Blerje Gazoil 10 ppm me fond limit : 18.604.167 (tetëmbëdhjetë milion e gjashtëqind e katër mijë e njëqind e gjashtëdhjetë e shtatë) lekë pa tvsh.

Loti II : Blerje Benzine , fondi: 462.500 (katëqind e gjashtëdhjetë e dy mijë e pesëqind) lekë pa tvsh.

Në bazë të nenit 21, pika 2, të Ligjit nr.162/2020 “Për prokurimin publik”, nenit 2, pika 2/c dhe nenit 78, pika 2, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, autoriteti/enti kontraktor shoqëria **UK Rajoni Elbasan**, ka hartuar procesverbalin për argumentimin dhe miratimin e specifikimeve teknike dhe kriterëve për kualifikim për procedurën e sipërcituar, me përmbajtjen si më poshtë:

METODOLOGJIA E PËRLLOGARITJES:

ÇMIMI PËR NJËSI u krye:

Referuar Aktit Normativ Nr.8, datë 25.3.2022 “Për disa ndryshime dhe shtesa në Ligjin Nr. 8450, datë 24.2.1999, “Për përpunimin, transportimin dhe tregtimin e naftës, të gazit dhe nënprodukteve të tyre”, të ndryshuar, konkretisht sipas përcaktimeve të nenit 21/5 njësia kreu përlllogaritjen e çmimit për njësi duke marrë çmimin mesatar të përlllogaritur për tre data të publikuara në tre Buletine të APP: nr. 12, datë 06.02.2023, **dhe publikimin më të fundit të ndryshimeve të çmimit të karburanteve nga Bordi i Transparencës, dt. 04. 02. 2023.**

LOTI I Blerje Gazoil 10ppm

1. KRITERET E PËRGJITHSHME TË PRANIMIT/KUALIFIKIM

Ofertuesi deklaron se:

- a) është i regjistruar në regjistrin tregtar sipas legjislacionit të vendit ku ushtron aktivitetin, ose sipas legjislacionit të posaçëm në rastin e një organizate jofitimprurëse, ka në fushën e veprimtarisë objektin e prokurimit, dhe ka statusin aktiv;
- b) nuk është në proces falimentimi (status aktiv);
- c) nuk është dënuar për ndonjë vepër penale, në përputhje me nenin 76/1 të LPP-së;
- ç) personi (personat) që veprojnë si anëtar i organit administrativ, drejtori ose mbikëqyrësi, aksioneri ose ortak, ose/që ka fuqi përfaqësuese, vendimmarrëse ose kontrolluese brenda Operatorit Ekonomik, nuk është i dënuar ose nuk ka qenë i dënuar nga një vendim i gjykatës i formës së prerë për çdo vepër penale, të përcaktuar në nenin 76/1 të LPP-së;
- d) nuk është dënuar me vendim gjyqësor të formës së prerë në lidhje me veprimtarinë profesionale;
- dh) nuk ka pagesa të pashlyera të taksave dhe kontributeve të sigurimeve shoqërore, ose ndodhet në një prej kushteve të parashikuara në nenin 76/2 të LPP-së;
- e) ka paguar energjinë elektrike dhe plotëson kërkesat që burojnë nga legjislacioni në fuqi. Ky informacion kërkohet për Operatorët Ekonomikë, të cilët operojnë në territorin e Republikës së Shqipërisë.
- f) nuk është në kushtet e konfliktit të interesit, sipas legjislacionit në fuqi;
- g) ushtron veprimtarinë në përputhje me legjislacionin përkatës mjedisor, social dhe të punës;
- gj) ka paraqitur një Ofertë të pavarur, sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi;
- h) kryen aktivitetin në përputhje me kërkesat e legjislacionit në fuqi.
- i) nuk ka në cilësinë e anëtarit të organit të administrimit, drejtues ose mbikëqyrës i atij, aksionar ose ortak, ose me kompetenca përfaqësuese, vendimmarrjeje ose kontrolluese brenda tij persona të cilët janë/kanë qenë në këtë cilësi në një operator ekonomik të përjashtuar nga e drejta për të përfituar fonde publike, me vendim të Agjencisë së Prokurimit Publik, gjatë kohës që ky vendim është në fuqi.

Nëse gjuha e përdorur në procedurë është gjuha shqipe, atëherë dokumentet e gjuhës së huaj duhet të shoqërohen nga një përkthim i noterizuar në shqip.

Këto kritere duhet të përmbushen me paraqitjen e Formularit Përmbledhës të Vetëdeklarimit të operatorit ekonomik në ditën e hapjes së Ofertës, sipas Shtojcës 8.

Në rast bashkimi të operatorëve ekonomikë, secili anëtar i grupit duhet të paraqesë Vetëdeklarimin e lartpërmendur.

Në rast se operatori ekonomik ofertues do të mbështetet në kapacitetet e subjekteve të tjera, Vetëdeklarimi i lartpërmendur duhet të paraqitet edhe nga subjekti mbështetës.

Kriteret e Përgjithshme të Pranimit nuk duhet të ndryshohen nga Autoritetet/Entet Kontraktore.

Në çdo rast, Autoriteti/Enti Kontraktor ka të drejtë të kryejë verifikimet e nevojshme për vërtetësinë e informacionit të deklaruar nga Operatori Ekonomik, për sa më sipër.

Nëse oferta paraqitet nga një bashkim Operatorësh Ekonomikë, do të paraqitet:

- Marrëveshje bashkëpunimi ndërmjet Operatorëve Ekonomikë, ku caktohet përfaqësuesi, përqindja e pjesëmarrjes në bashkim, dhe elementët që merr përsipër të realizojë secili prej anëtarëve të bashkimit.
- Nëse, një operator ekonomik dëshiron të mbështetet në kapacitetet e subjekteve të tjera, ai i vërteton autoritetit ose entit kontraktor se do të ketë në dispozicion burimet e nevojshme, duke dorëzuar një angazhim me shkrim të këtyre subjekteve për këtë qëllim.

2. KRITERET E VEÇANTA TË KUALIFIKIMIT

1. Ofertuesi duhet të paraqesë:

a. *Formularin Përmbledhës të Vetë-deklarimit, sipas shtojcës 8*

b. *Sigurimin e Ofertës, sipas Shtojcës 3;*

Argumentimi: Kërkesat e mësipërme bazohen në nenet 76, 82 dhe 83 të LPP, nenit 26, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”.

Argumentimi i AK: Vlera e sigurimit të ofertës është llogaritur në 2% të vlerës së fondit limit siç është parashikuar në ligj.

2. Kandidati/Ofertuesi duhet të dorëzojë

2.1. Përshtatshmëria për të kryer veprimtarinë profesionale (nëse është e aplikueshme):

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme bazohet në nenin 77, pika 1/a dhe 2, të LPP, nenit 40, pika 5, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 ”Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”,

.....
(Shënim: *përcaktoni nëse është rasti, aktin konkret ligjor ose nënligjor që parashikon plotësimin e ndonjë kërkesë specifike për ushtrimin e veprimtarisë profesionale që lidhet me objektin e prokurimit).*

2.2. Kapaciteti ekonomik dhe financiar:

Operatori ekonomik ofertues të vërtetojë që:

Xhiroja vjetore minimale e të paktën njërit nga tre 3 (tre) vitet e fundit financiarë nga data e zhvillimit të tenderit, nuk mund të tejkalojë vlerën e përlogaritur të kontratës ose lotit.

Argumentimi Ligjor: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në vlerën e fondit limit të kësaj procedure, si dhe bazuar në nenin 77, pika 3, e LPP, si dhe nenin 43 pika 2/b dhe 5, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”.

Përcaktimi i vlerës së kërkuar argumentohet si më poshtë:

Argumentimi i AK : Vlera e xhiros së kërkuar është vendosur duke pasur në konsideratë objektin e kontratës, natyrën dhe volumin e saj. Vlera e xhiros është vendosur që t’i shërbejnë autoritetit kontraktor për njohjen e gjendjes dhe kapaciteteve të operatorëve ekonomikë, të cilët, nëpërmjet dokumentacionit të paraqitur duhet të vërtetojnë se zotërojnë kapacitetet e nevojshme në funksion të realizimit me sukses të kontratës. Përcaktimi i viteve të kërkuara për paraqitjen e vërtetimit të xhiros vjetore është bërë bazuar në Ligjin nr. 8438, datë 28.12.1998 "Për tatimin mbi të ardhurat", i ndryshuar, Udhëzimit të Ministrit të Financave nr.5, datë 30.01.2006, "Për tatimin mbi të ardhurat", i ndryshuar, VKM-së nr. 922 datë 29.12.2014 "Për deklarimin e detyrueshëm të deklaratave tatimore dhe të dokumenteve të tjera tatimore, vetëm nëpërmjet forës elektronike".

2.3 Aftësitë teknike dhe profesionale:

Operatori ekonomik ofertues të paraqesë eksperiencën të mëparshme ku të vërtetojë se ka kryer dhe realizuar kontrata të ngjashme në 3 (tre) vitet e fundit të ushtrimit të aktivitetit nga data e shpalljes së njoftimit të kontratës në një vlerë jo më të vogël se 40% të vlerës së përlllogaritur të kontratës objekt prokurimi.

a- Në rastin e përvojës së mëparshme të realizuar me sektorin publik, operatori ekonomik ofertues duhet të paraqesë vërtetime të lëshuara nga një ent publik për përmbushjen me sukses të kontratës, ku të shënohen vlera, afati i përfundimit të kontratës ose/dhe fatura tatimore shitjesh të plotësuara sipas legjislacionit në fuqi, ku shënohen datat, shumat dhe sasi të mallrave të furnizuara.

b- Në rastin e përvojës së mëparshme të realizuar me sektorin privat, operatori ekonomik ofertues duhet të paraqesë fatura tatimore shitjesh të plotësuara sipas legjislacionit në fuqi dhe të deklaruara në organet tatimore ku shënohen datat, shumat dhe sasi të mallrave të furnizuara.

Argumentimi ligjor: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77 të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” dhe nenin 40, pika 4, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”.

Argumentimi i AK: Me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë përvojën e nevojshme për të zbatuar kontratën, prandaj është kërkuar që furnizimet e mëparshme të ngjashme të jenë në vlerën jo më pak se 40 % të vlerës së fondit limit, që është brenda vlerës kufi të përcaktuar në nenin e sipërcituar.

2.3.1 Operatori Ekonomik ofertues duhet të jetë i certifikuar sipas sistemit të menaxhimit të cilësisë ISO 9001-2015 ose ekuivalentë të vlefshëm që i referohet objektit të prokurimit.

Argumentimi ligjor dhe i AK: Referuar nenit 40 pika 6/c, dhe 44 pika 1 të VKM 285 datë 19.05.2021. Ky certifikim tashmë një standart gjerësisht i kërkuar në fushën e prokurimeve publike, i mundëson AK për të verifikuar dhe krijuar besimin që OE ofertues është në gjendje të realizojë kontratën në mënyrë cilësore. Ky kriter e siguron AK se OE që do të shpallet fitues është e certifikuar sipas këtij standarti, rezulton një kompani serioze e certifikuar në menaxhimin e cilësisë.

2.3.2 Operatori ekonomik pjesëmarrës duhet të jetë i certifikuar sipas standardeve ndërkombëtare ISO 14001 ose ekuivalente të vlefshme, të Sistemit të Menaxhimit të Mjedisit. Qëllimi i certifikimit të kompanisë duhet të jetë sipas objektit që do të prokurohet.

Argumentimi ligjor dhe i AK: Referuar nenit 40 pika 6/c, nenit 43 dhe 44 pika 2 të VKM 285 datë 19.05.2021, neni 88 pika 3. Ky certifikim gjerësisht i kërkuar në fushën e prokurimeve në respektim të standarteve me impakt të ndjeshëm mjedisor.

Çertifikatat të jenë të lëshuar nga një organ i vlerësimit të konformitetit, i akredituar nga organizmi kombëtar i akreditimit ose organizma ndërkombëtarë akreditues, të njohur nga Republika e Shqipërisë.

Në rastin e bashkimit të operatorëve ekonomik, secili operator ekonomik duhet të dorëzojë certifikata ISO sipas zërave të mallrave që do të marrë përsipër të realizojë sipas aktmarrëveshjes.

2.3.3 Operatori ekonomik duhet të paraqesë një vërtetim të lëshuar nga ISHTI, që vërteton se subjekti ofertues ka tregtuar karburante sipas standarteve të legjislacionit shqiptar dhe nuk ka patur penalitete për shkelje të cilësisë përgjatë vitit 2022.

Argumentimi ligjor: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik”, nenit 40, pika 6, gërma c, dhe neni 44 të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”.

Argumentimi i AK: Kjo kërkesë është parësore për AK si kriter i veçantë i cilësisë së mallrave që prokurohen dhe, garancisë së Furnizuesit në marrëdhëniet kontraktuale për këtë objekt prokurimi.

2.3.4 Operatori ekonomik duhet detyrimisht të paraqesë në tender një ose më shumë raport analize të tregut të brendshëm të lëshuar nga ISHTI. Raport (Fletë) analiza e tregut të brendshëm duhet të jetë lëshuar brenda 60 ditëve nga data e hapjes së ofertave.

Argumentimi ligjor: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik”, nenit 40, pika 6, gërma c,) dhe neni 44 të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”.

Argumentimi i AK: Në funksion të përlllogaritjes dhe hartimit të kontratave në zbatim, ky kriter përbën element thelbësor në përcaktimin e çmimit të karburantit (psh densiteti është pasqyruar në fletë analizë).

AK gjykon dhe argumenton se fletë analiza e kërkuar 60 ditë nga data e hapjes së tenderit motivohet:

- Së pari, sepse jep vlerën e densitetit i cili shërben për kontrollin e çmimit për njësi, sepse influencon ndjeshëm nga kufiri minimal në kufirin maksimal (0,820-0,845 për gazoil ose benzina 0,720-0,775).

- Së dyti, referuar procedurave të vitit 2022 për këtë objekt prokurimi nga ente të tjera publike për efekt krahasimi, AK konstaton se afati 60 ditor është maksimal, mjaft tolerant krahasuar me 30 ditë të kërkuar nga autoritete të tjera kontraktore.

2.3.5 Për arsye të specifikës të punës së shoqërisë dhe lëvizjeve të shpeshta që kryhen në gjithë rajonin, subjekti ofertues duhet të paraqesë listën e stacioneve të shitjes së karburanteve me pakicë sipas adresave të kërkuara nga Autoriteti Kontraktor më poshtë, vërtetuar me një nga format e disponimit sipas Kodit Civil (kontratë qiraje ose akt pronësie ose të jenë të pasqyruara në ekstraktin e regjistrimit tregtar lëshuar nga QKB).

Stacionet e tregtimit me pakicë të karburanteve detyrimisht duhen të jenë të pajisur me:

- Licensë lëshuar nga pushteti vendor,
- Leje mjedisore të tipit B lëshuar nga QKL,
- Vërtetim teknik lëshuar nga Organet e Miratuara të Vlerësimit të Konformitetit (OMVK),
- Certifikatë të mbrotjes nga zjarri dhe shpëtimi (MNZSH)
- Policë sigurimi në një nga shoqëritë e sigurimeve që operojnë në Shqipëri, për distributorët e shitjes me pakicë, të cilat duhet të jenë brenda afatit të vlefshmërisë në datën e hapjes së ofertave.

Kërkohet të ketë minimumi nga 1 (Një) Stacion tregtimi të karburanteve në çdo nga qytetet Gramsh, Librazhd, Peqin, Elbasan, Belsh, Cërrik, brenda kufirit territorial të çdo qyteti të sipërpërmendur.

Argumentimi ligjor: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik”, nenit 40, pikat 3 dhe 5, gërma a,) të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”.

Argumentimi i AK: Në konceptimin e këtij kriteri AK ka pasur në konsideratë arsyetimin dhe logjikën e argumentuar, me faktin që shoqëria ushtron aktivitetin e saj në njësitë Gramsh, Librazhd, Peqin, Elbasan, Belsh, Cërrik. Do të ishte e nevojshme pika e tregtimit në afërsi të këtyre njësive, pasi kjo do të reduktojë lëvizjen e mjeteve, ul konsumin e panevojshëm të karburantit dhe rrit përfitimin e kohës së punës.

Për sa i përket elementëve të tjerë të kërkuar të integruar në të, AK i argumenton si komplementare dhe të arsyeshëm në përmbushjen e kapaciteteve teknike dhe që i garantojnë AK seriozitetin dhe besueshmërinë e operatorit ekonomik fitues në gjendje për të përmbushur detyrimet kontraktuale. Përcaktimi i akteve është bazuar në funksion të mbulimit optimal të territorit që shoqëria administron me pika karburanti, në mënyrë që mjetet e institucionit të mund të aksesojnë në këto shërbime pa vonesa dhe evitimin e te papriturave pa kompromentuar kështu zhvillimin e përditshmërisë së punës.

2.3.6 Bazuar në VKM Nr. 561 datë 29.07.2016 “Për Standartizimin dhe disiplinimin e shpenzimeve të karburantit në njësitë e qeverisjes së përgjithshëm“, Operatorët ekonomik pjesëmarrës, duhet të ofrojnë një faqe menaxhimi të karburanteve (webpage), ku furnizimi dhe shpenzimi i karburantit për mjetet efektive të transportit, të kryhet me kartë elektronike.

Faqja e menaxhimit të karburanteve (webpage) duhet të ofrojë shërbimin e ngarkimit të sasisë së karburantit nga Operatori ekonomik drejt Autoritetit Kontraktor, me qëllim që rimbushja e kartave elektronike të personalizuar me targën e mjetit, si dhe administrimi i sasisë së karburanteve, të kryhet nga vetë AK. Ndërfaqja duhet të ofrojë edhe mundësinë e afishimit, si dhe administrimi i sasisë së karburanteve të kryhet nga vetë Autoriteti Kontraktor.

Mos ofrimi i shërbimeve të kërkuara më sipër në mënyrë elektronike nëpërmjet Faqes së menaxhimit të karburanteve (webpage), që ofron çdo operator ekonomik pjesëmarrës, përbën kusht për skualifikim.

Argumentimi ligjor per pikat 2.3.6-9: Kërkesat e mësipërme janë përcaktuar bazuar në nenin 77, pika 4 të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik”, nenit 40, pika , gërma ç, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik” *si dhe bazuar ne VKM Nr 561 datë 29.07.2016 “Për Standartizimin dhe disiplinimin e shpenzimeve të karburantit në njësitë e qeverisjes së përgjithshem”*

Argumentimi i AK: Për pikat 2.3.6 - 2.3.9: Vetë-deklarimet e mësipërme (si dhe procedura e demonstrimit) kërkohen nga AK si garanci që furnizimi do të realizohet me karta elektronike.

Të gjitha dokumentet duhet të jenë origjinale ose kopje të noterizuara. Rastet e mosparaqitjes së një dokumenti, ose dokumente false dhe të pasakta, konsiderohen kushte për skualifikim.

Për dokumentet në gjuhë të huaj, të respektohen dispozitat sipas legjislacionit në fuqi.

Specifikimet teknike

*Shënim: Përcaktoni specifikimet teknike, për mallrat objekt prokurimi, të cilat duhet të përshkruajnë minimumin ose tërësinë e elementeve më të rëndësishme përbërëse, që garantojnë cilësinë e kërkuar, dhe që i vlerëson mallrat si të pranueshme për funksionet e kërkuara, në përputhje me parashikimet e nenit 4, pika 38/b dhe nenit 36, të LPP, si dhe nenit 40, pika 2, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021, “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, **duke argumentuar çdo kërkesë funksionale ose performance, apo/dhe çdo standard të kërkuar, ku çdo referencë duhet të shoqërohet nga fjalët “ose ekuivalenti i tij/saj”.***

Kujdes: Në specifikimet teknike, nëse nuk e justifikon objekti i kontratës, nuk duhet të përmendet asnjë markë prodhimi ose burim specifik apo proces i veçantë, që karakterizon produktet ose shërbimet e ofruara nga një operator ekonomik specifik apo asnjë markë tregtare, patentë, tipi ose origjinë apo prodhim specifik, me qëllim favorizimin ose eliminimin e disa sipërmarrjeve ose produkteve. Një gjë e tillë lejohet vetëm në raste përjashtimore kur nuk ekziston një mënyrë e mjaftueshme, e saktë apo e kuptueshme e përshkrimit të objektit të kontratës, sipas pikës 3 të nenit 36, të LPP. Referime të tilla duhet të shoqërohen nga fjalët “ose ekuivalente”.

LOTI I Blerje Gazoil 10ppm

1. KRITERET E PËRGJITHSHME TË PRANIMIT/KUALIFIKIM

Ofertuesi deklaron se:

- a) është i regjistruar në regjistrin tregtar sipas legjislacionit të vendit ku ushtron aktivitetin, ose sipas legjislacionit të posaçëm në rastin e një organizate jofitimprurëse, ka në fushën e veprimtarisë objektin e prokurimit, dhe ka statusin aktiv;
- b) nuk është në proces falimentimi (status aktiv);
- c) nuk është dënuar për ndonjë vepër penale, në përputhje me nenin 76/1 të LPP-së;

- c) personi (personat) që veprojnë si anëtar i organit administrativ, drejtori ose mbikëqyrësi, aksioneri ose ortak, ose/që ka fuqi përfaqësuese, vendimmarrëse ose kontrolluese brenda Operatorit Ekonomik, nuk është i dënuar ose nuk ka qenë i dënuar nga një vendim i gjykatës i formës së prerë për çdo vepër penale, të përcaktuar në nenin 76/1 të LPP-së;
- d) nuk është dënuar me vendim gjyqësor të formës së prerë në lidhje me veprimtarinë profesionale;
- dh) nuk ka pagesa të pashlyera të taksave dhe kontributeve të sigurimeve shoqërore, ose ndodhet në një prej kushteve të parashikuara në nenin 76/2 të LPP-së;
- e) ka paguar energjinë elektrike dhe plotëson kërkesat që burojnë nga legjislacioni në fuqi. Ky informacion kërkohet për Operatorët Ekonomikë, të cilët operojnë në territorin e Republikës së Shqipërisë.
- f) nuk është në kushtet e konfliktit të interesit, sipas legjislacionit në fuqi;
- g) ushtron veprimtarinë në përputhje me legjislacionin përkatës mjedisor, social dhe të punës;
- gj) ka paraqitur një Ofertë të pavarur, sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi;
- h) kryen aktivitetin në përputhje me kërkesat e legjislacionit në fuqi.
- i) nuk ka në cilësinë e anëtarit të organit të administrimit, drejtues ose mbikëqyrës i atij, aksionar ose ortak, ose me kompetenca përfaqësuese, vendimmarrjeje ose kontrolluese brenda tij persona të cilët janë/kanë qenë në këtë cilësi në një operator ekonomik të përjashtuar nga e drejta për të përfituar fonde publike, me vendim të Agjencisë së Prokurimit Publik, gjatë kohës që ky vendim është në fuqi.

Nëse gjuha e përdorur në procedurë është gjuha shqipe, atëherë dokumentet e gjuhës së huaj duhet të shoqërohen nga një përkthim i noterizuar në shqip.

Këto kritere duhet të përmbushen me paraqitjen e Formularit Përmbledhës të Vetëdeklarimit të operatorit ekonomik në ditën e hapjes së Ofertës, sipas Shtojcës 8.

Në rast bashkimi të operatorëve ekonomikë, secili anëtar i grupit duhet të paraqesë Vetëdeklarimin e lartpërmendur.

Në rast se operatori ekonomik ofertues do të mbështetet në kapacitetet e subjekteve të tjera, Vetëdeklarimi i lartpërmendur duhet të paraqitet edhe nga subjekti mbështetës.

Kriteret e Përgjithshme të Pranimit nuk duhet të ndryshohen nga Autoritetet/Entet Kontraktore.

Në çdo rast, Autoriteti/Enti Kontraktor ka të drejtë të kryejë verifikimet e nevojshme për vërtetësinë e informacionit të deklaruar nga Operatori Ekonomik, për sa më sipër.

Nëse oferta paraqitet nga një bashkim Operatorësh Ekonomikë, do të paraqitet:

- Marrëveshje bashkëpunimi ndërmjet Operatorëve Ekonomikë, ku caktohet përfaqësuesi, përqindja e pjesëmarrjes në bashkim, dhe elementët që merr përsipër të realizojë secili prej anëtarëve të bashkimit.
- Nëse, një operator ekonomik dëshiron të mbështetet në kapacitetet e subjekteve të tjera, ai i vërteton autoritetit ose entit kontraktor se do të ketë në dispozicion burimet e nevojshme, duke dorëzuar një angazhim me shkrim të këtyre subjekteve për këtë qëllim.

2. KRITERET E VEÇANTA TË KUALIFIKIMIT

1. Ofertuesi duhet të paraqesë:

a. Formularin Përmbledhës të Vetë-deklarimit, sipas shtojcës 8

b. Sigurimin e Ofertës, sipas Shtojcës 3;

Argumentimi: Kërkesat e mësipërme bazohen në nenet 76, 82 dhe 83 të LPP, nenit 26, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”.

Argumentimi i AK: Vlera e sigurimit të ofertës është llogaritur në 2% të vlerës së fondit limit siç është parashikuar në ligj.

2. Kandidati/Ofertuesi duhet të dorëzojë

2.1. Përshtatshmëria për të kryer veprimtarinë profesionale (nëse është e aplikueshme):

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme bazohet në nenin 77, pika 1/a dhe 2, të LPP, nenit 40, pika 5, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”,

.....
(Shënim: përcaktoni **nëse është rasti**, aktin konkret ligjor ose nënligjor që parashikon plotësimin e ndonjë kërkesë specifike për ushtrimin e veprimtarisë profesionale që lidhet me objektin e prokurimit).

2.2. Kapaciteti ekonomik dhe financiar:

Operatori ekonomik ofertues të vërtetojë që:

Xhiroja vjetore minimale e të paktën njërit nga tre 3 (tre) vitet e fundit financiarë nga data e zhvillimit të tenderit, nuk mund të tejkalojë vlerën e përlogaritur të kontratës ose lotit.

Argumentimi Ligjor: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në vlerën e fondit limit të kësaj procedure, si dhe bazuar në nenin 77, pika 3, e LPP, si dhe nenin 43 pika 2/b dhe 5, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”.

Përcaktimi i vlerës së kërkuar argumentohet si më poshtë:

Argumentimi i AK : Vlera e xhiros së kërkuar është vendosur duke pasur në konsideratë objektin e kontratës, natyrën dhe volumin e saj. Vlera e xhiros është vendosur që t’i shërbejnë autoritetit kontraktor për njohjen e gjendjes dhe kapaciteteve të operatorëve ekonomikë, të cilët, nëpërmjet dokumentacionit të paraqitur duhet të vërtetojnë se zotërojnë kapacitetet e nevojshme në funksion të realizimit me sukses të kontratës. Përcaktimi i viteve të kërkuara për paraqitjen e vërtetimit të xhiros vjetore është bërë bazuar në Ligjin nr. 8438, datë 28.12.1998 "Për tatimin mbi të ardhurat", i ndryshuar, Udhëzimit të Ministrit të Financave nr.5, datë 30.01.2006, "Për tatimin mbi të

ardhurat", i ndryshuar, VKM-së nr. 922 datë 29.12.2014 "Për deklarimin e detyrueshëm të deklaratave tatimore dhe të dokumenteve të tjera tatimore, vetëm nëpërmjet forës elektronike".

2.3 Aftësitë teknike dhe profesionale:

Operatori ekonomik ofertues të paraqesë eksperiencën të mëparshme ku të vërtetojë se ka kryer dhe realizuar kontrata të ngjashme në 3 (tre) vitet e fundit të ushtrimit të aktivitetit nga data e shpalljes së njoftimit të kontratës në një vlerë jo më të vogël se 40% të vlerës së përlogaritur të kontratës objekt prokurimi.

a- Në rastin e përvojës së mëparshme të realizuar me sektorin publik, operatori ekonomik ofertues duhet të paraqesë vërtetime të lëshuara nga një ent publik për përmbushjen me sukses të kontratës, ku të shënohen vlera, afati i përfundimit të kontratës ose/dhe fatura tatimore shitjesh të plotësuara sipas legjislacionit në fuqi, ku shënohen datat, shumat dhe sasi të mallrave të furnizuara.

b- Në rastin e përvojës së mëparshme të realizuar me sektorin privat, operatori ekonomik ofertues duhet të paraqesë fatura tatimore shitjesh të plotësuara sipas legjislacionit në fuqi dhe të deklaruara në organet tatimore ku shënohen datat, shumat dhe sasi të mallrave të furnizuara.

Argumentimi ligjor: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77 të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 "Për prokurimin publik" dhe nenit 40, pika 4, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 "Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik".

Argumentimi i AK: Me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë përvojën e nevojshme për të zbatuar kontratën, prandaj është kërkuar që furnizimet e mëparshme të ngjashme të jenë në vlerën jo më pak se 40 % të vlerës së fondit limit, që është brenda vlerës kufi të përcaktuar në nenin e sipërcituar.

2.3.1 Operatori Ekonomik ofertues duhet të jetë i certifikuar sipas sistemit të menaxhimit të cilësisë ISO 9001-2015 ose ekuivalentë të vlefshëm që i referohet objektit të prokurimit.

Argumentimi ligjor dhe i AK: Referuar nenit 40 pika 6/c, dhe 44 pika 1 të VKM 285 datë 19.05.2021. Ky certifikim tashmë një standart gjerësisht i kërkuar në fushën e prokurimeve publike, i mundëson AK për të verifikuar dhe krijuar besimin që OE ofertues është në gjendje të realizojë kontratën në mënyrë cilësore. Ky kriter i siguron AK se OE që do të shpallet fitues është e certifikuar sipas këtij standarti, rezulton një kompani serioze e certifikuar në menaxhimin e cilësisë.

2.3.2 Operatori ekonomik pjesëmarrës duhet të jetë i certifikuar sipas standardeve ndërkombëtare ISO 14001 ose ekuivalente të vlefshme, të Sistemit të Menaxhimit të Mjedisit. Qëllimi i certifikimit të kompanisë duhet të jetë sipas objektit që do të prokurohet.

Argumentimi ligjor dhe i AK: Referuar nenit 40 pika 6/c, nenit 43 dhe 44 pika 2 të VKM 285 datë 19.05.2021, neni 88 pika 3. Ky certifikim gjerësisht i kërkuar në fushën e prokurimeve në respektim të standarteve me impakt të ndjeshëm mjedisor.

Çertifikatat të jenë të lëshuara nga një organ i vlerësimit të konformitetit, i akredituar nga organizmi kombëtar i akreditimit ose organizma ndërkombëtarë akreditues, të njohur nga Republika e Shqipërisë.

Në rastin e bashkimit të operatorëve ekonomik, secili operator ekonomik duhet të dorëzojë certifikata ISO sipas zërave të mallrave që do të marrë përsipër të realizojë sipas aktmarrëveshjes.

2.3.3 Operatori ekonomik duhet të paraqesë një vërtetim të lëshuar nga ISHTI, që vërteton se subjekti ofertues ka tregtuar karburante sipas standarteve të legjislacionit shqiptar dhe nuk ka patur penalitete për shkelje të cilësisë përgjatë vitit 2022.

Argumentimi ligjor: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik”, nenit 40, pika 6, gërma c, dhe neni 44 të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”.

Argumentimi i AK: Kjo kërkesë është parësore për AK si kriter i veçantë i cilësisë së mallrave që prokurohen dhe, garancisë së Furnizuesit në marrëdhëniet kontraktuale për këtë objekt prokurimi.

2.3.4 Operatori ekonomik duhet detyrimisht të paraqesë në tender një ose më shumë raport analize të tregut të brendshëm të lëshuar nga ISHTI. Raport (Fletë) analiza e tregut të brendshëm duhet të jetë lëshuar brenda 60 ditëve nga data e hapjes së ofertave.

Argumentimi ligjor: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik”, nenit 40, pika 6, gërma c,) dhe neni 44 të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”.

Argumentimi i AK: Në funksion të përlllogaritjes dhe hartimit të kontratave në zbatim, ky kriter përbën element thelbësor në përcaktimin e çmimit të karburantit (psh densiteti është pasqyruar në fletë analizë).

AK gjykon dhe argumenton se fletë analiza e kërkuar 60 ditë nga data e hapjes së tenderit motivohet:

- Së pari, sepse jep vlerën e densitetit i cili shërben për kontrollin e çmimit për njësi, sepse influencon ndjeshëm nga kufiri minimal në kufirin maksimal (0,820-0,845 për gazoil ose benzina 0,720-0,775).
- Së dyti, referuar procedurave të vitit 2022 për këtë objekt prokurimi nga ente të tjera publike për efekt krahasimi, AK konstaton se afati 60 ditor është maksimal, mjaft tolerant krahasuar me 30 ditë të kërkuar nga autoritete të tjera kontraktore.

2.3.5 Për arsye të specifikës të punës së shoqërisë dhe lëvizjeve të shpeshta që kryhen në gjithë rajonin, subjekti ofertues duhet të paraqesë listën e stacioneve të shitjes së karburanteve me pakicë sipas adresave të kërkuara nga Autoriteti Kontraktor më poshtë, vërtetuar me një nga format e disponimit sipas Kodit Civil (kontratë qiraje ose akt pronësie ose të jenë të pasqyruara në ekstraktin e regjistrimit tregtar lëshuar nga QKB).

Stacionet e tregtimit me pakicë të karburanteve detyrimisht duhen të jenë të pajisur me:

- Licensë lëshuar nga pushteti vendor,
- Leje mjedisore të tipit B lëshuar nga QKL,
- Vërtetim teknik lëshuar nga Organet e Miratuara të Vlerësimit të Konformitetit (OMVK),
- Certifikatë të mbrotjes nga zjarri dhe shpëtimi (MNZSH)

- Policë sigurimi në një nga shoqëritë e sigurimeve që operojnë në Shqipëri, për distributorët e shitjes me pakicë, të cilat duhet të jenë brenda afatit të vlefshmërisë në datën e hapjes së ofertave.

Kërkohej të ketë minimumi nga 1 (Një) Stacion tregtimi të karburanteve në çdo nga qytetet Gramsh, Librazhd, Peqin, Elbasan, Belsh, Cërrik, brenda kufirit territorial të çdo qyteti të sipërpërmendur.

Argumentimi ligjor: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik”, nenit 40, pikat 3 dhe 5, gërma a,) të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”.

Argumentimi i AK: Në konceptimin e këtij kriteri AK ka pasur në konsideratë arsyetimin dhe logjikën e argumentuar, me faktin që shoqëria ushtron aktivitetin e saj në njësitë Gramsh, Librazhd, Peqin, Elbasan, Belsh, Cërrik. Do të ishte e nevojshme pika e tregtimit në afërsi të këtyre njësiteve, pasi kjo do të reduktojë lëvizjen e mjeteve, ul konsumin e panevojshëm të karburantit dhe rrit përfitimin e kohës së punës.

Për sa i përket elementëve të tjerë të kërkuar të integruar në të, AK i argumenton si komplementare dhe të arsyeshëm në përmbushjen e kapaciteteve teknike dhe që i garantojnë AK seriozitetin dhe besueshmërinë e operatorit ekonomik fitues në gjendje për të përmbushur detyrimet kontraktuale. Përcaktimi i akteve është bazuar në funksion të mbulimit optimal të territorit që shoqëria administron me pika karburanti, në mënyrë që mjetet e institucionit të mund të aksesojnë në këto shërbime pa vonesa dhe evitimin e te papriturave pa kompromentuar kështu zhvillimin e përditshmërisë së punës.

2.3.6 Bazuar në VKM Nr. 561 datë 29.07.2016 “Për Standartizimin dhe disiplinimin e shpenzimeve të karburantit në njësitë e qeverisjes së përgjithshëm“, Operatorët ekonomik pjesëmarrës, duhet të ofrojnë një faqe menaxhimi të karburanteve (webpage), ku furnizimi dhe shpenzimi i karburantit për mjetet efektive të transportit, të kryhet me kartë elektronike.

Faqja e menaxhimit të karburanteve (webpage) duhet të ofrojë shërbimin e ngarkimit të sasisë së karburantit nga Operatori ekonomik drejt Autoritetit Kontraktor, me qëllim që rimbushja e kartave elektronike të personalizuar me targën e mjetit, si dhe administrimi i sasisë së karburanteve, të kryhet nga vetë AK. Ndërfaqja duhet të ofrojë edhe mundësinë e afishimit, si dhe administrimi i sasisë së karburanteve të kryhet nga vetë Autoriteti Kontraktor.

Mos ofrimi i shërbimeve të kërkuara më sipër në mënyrë elektronike nëpërmjet Faqes së menaxhimit të karburanteve (webpage), që ofron çdo operator ekonomik pjesëmarrës, përbën kusht për skualifikim.

Argumentimi ligjor për pikat 2.3.6-9: Kërkesat e mësipërme janë përcaktuar bazuar në nenin 77, pika 4 të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik”, nenit 40, pika , gërma ç, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik” *si dhe bazuar në VKM Nr 561 datë 29.07.2016 “Për Standartizimin dhe disiplinimin e shpenzimeve të karburantit në njësitë e qeverisjes së përgjithshme”*

Argumentimi i AK: Për pikat 2.3.6 - 2.3.9: Vetë-deklarimet e mësipërme (si dhe procedura e demonstrimit) kërkohej nga AK si garanci që furnizimi do të realizohet me karta elektronike.

Të gjitha dokumentet duhet të jenë origjinale ose kopje të noterizuara. Rastet e mosparaqitjes së një dokumenti, ose dokumente false dhe të pasakta, konsiderohen kushte për skualifikim.

Për dokumentet në gjuhë të huaj, të respektohen dispozitat sipas legjislacionit në fuqi.

Specifikimet teknike

*Shënim: Përcaktoni specifikimet teknike, për mallrat objekt prokurimi, të cilat duhet të përshkruajnë minimumin ose tërësinë e elementeve më të rëndësishme përbërëse, që garantojnë cilësinë e kërkuar, dhe që i vlerëson mallrat si të pranueshme për funksionet e kërkuara, në përputhje me parashikimet e nenit 4, pika 38/b dhe nenit 36, të LPP, si dhe nenit 40, pika 2, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021, “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, **duke argumentuar çdo kërkesë funksionale ose performance, apo/dhe çdo standard të kërkuar**, ku çdo referencë duhet të shoqërohet nga fjalët “ose ekuivalenti i tij/saj”.*

Kujdes: Në specifikimet teknike, nëse nuk e justifikon objekti i kontratës, nuk duhet të përmendet asnjë markë prodhimi ose burim specifik apo proces i veçantë, që karakterizon produktet ose shërbimet e ofruara nga një operator ekonomik specifik apo asnjë markë tregtare, patentë, tipi ose origjinë apo prodhim specifik, me qëllim favorizimin ose eliminimin e disa sipërmarrjeve ose produkteve. Një gjë e tillë lejohet vetëm në raste përjashtimore kur nuk ekziston një mënyrë e mjaftueshme, e saktë apo e kuptueshme e përshkrimit të objektit të kontratës, sipas pikës 3 të nenit 36, të LPP. Referime të tilla duhet të shoqërohen nga fjalët “ose ekuivalente”.